Albanian Gas Services Company Sh.a
Rruga e Kosovareve, Pallati NderPro sh.p. Tirana, Albania
Share Capital: ALL 3.500.000,00
NUIS: L82407006D

**RESOLUTION OF THE SUPERVISORY BOARD OF**

**OF**

**"ALBANIAN GAS SERVICE COMPANY" SH. A**

On this 21.07.2020 at 18:00 o'clock, pursuant to the Articles of Association of the company ALBANIAN GAS SERVICE COMPANY SHA, a company duly established and existing under laws of the Republic of Albania registered with the commercial registry held by the National Registration Center under NIPT no. L82407006D with registered address in Rruga e Kosovareve, pallati NderPro sh.p.k, Tirana, Albania (the "**Company**"), pursuant to Law no. 9901/2008 "On entrepreneurs and commercial enterprises" as amended (Albanian Company Law), it is being convoked the Supervisory Board of the Company, composed by its members as follows:

- **Mr. Mario Franchin;**
- **Mr. Michele Calì;**
- **Mr. Enea Karakaci;**
- **Mr. Oltion Rrumbullaku;**
- **Mr. Renald Koka;**

to discuss and resolve upon the following

**AGENDA**:

1. Update on the activities of the first semester 2020.
2. Update on HSE activities of the first semester 2020.
3. Approval of the Company Financial statement for the Financial year 2019 revised by the independent Auditors.
4. Approval of the Corporate System Framework design.
5. Resignation of Mr. Giuseppe Peluso from the position of Administrator (Chief Operating Officer) of the Company and appointment of a new Administrator (Chief Operating Officer) of the Company as well as delegation of powers to the newly elected Chief Operating Officer of the Company.
6. Any other business.

All the members attending the meeting observed that:

- they have been duly notified on the meeting and on the agenda, and they approve any modality of notification and convocation of this meeting of the Supervisory Board of the Company and consider it validly constituted and convoked;
- the presence of the members in the meeting either personally, or via video conference means, is in compliance with the quorum foreseen in the Article of Associations necessary

to consider the meeting as valid, in order to resolve on the items of the agenda. The following members are attending:

- Mr. Mario Franchin *attending via video conference*;
- Mr. Michele Calì *attending via video conference*;
- Mr. Enea Karakaci *attending via video conference*;
- Mr. Oltion Rrumbullaku *attending via video conference*;
- Mr. Renald Koka *attending via video conference;*

- The members of the Supervisory Board have discussed and have been informed on the details of the issues to be discussed and to be resolved upon.

- The Administrators of the Company: the CEO Mr. Arber Lleshi and the COO Mr. Giuseppe Peluso, also attend the meeting.

- Roberto Zingoni, Andrea Romeo, Massimiliano Lamberti Fontana and Parid Shkurti also attend the meeting.

- For purposes of this meeting Mr. Gabriele Lopez Cesarino, was appointed as Secretary, who accepted the temporary appointment.

**THEREFORE**

1. With regard to the **first topic** of the agenda, the Chairman invites the Administrators to inform the meeting on the update on 2020 activities to date. The Administrators give the floor to Mr. Gabriele Lopez Cesarino, who updates the Supervisory Board Members about the activities of 2020 to date as illustrated in detail in the document attached hereto under exhibit 1. The Chairman asked if the completion of procurement plan presented is feasible considering TAP requirements and Public Procurement Procedure. The CEO informed that a draft of the new Public Procurement Law is currently under revision and that in the forthcoming months the procurement of certain goods/works/services needed for operational activities might fall out of the Public Procurement Law. Gabriele Lopez Cesarino inform also that six Company rules that constitute the core of the Company Management System have been drafted and have been approved by the Administrators. Finally, the CEO updated on the economic figures of the Company up to May 31st 2020. The Supervisory Board acknowledge the update of 2020 activities to date and endorses the approvals of the Company regulations.

2. With regard to the **second topic** of the agenda, the Chairman invites the Administrators to inform the meeting on the HSE update on first half 2020. The Administrators give the floor to Mr. Andrea Romeo, the HSE Manager, who explains in detail the progress of HSE activities as illustrated in the document attached hereto under exhibit 2. The Supervisory Board acknowledge and endorses the HSE update on first half 2020.

3. With regard to the **third topic** of the agenda, the Chairman invites the Administrators to inform the meeting on the Company Financial Statement for the year 2019 revised by the Independent Auditors. The Administrators give the floor to the AFC Manager that explains in detail the main features of the Financial Statement. In particular, the economic results

of the profit and loss statement present an improvement both in the operating income and in the net profit with respect to the budget revision approved by the Supervisory Board on April 9th 2019. The details of the Company Financial Statement for the year 2019 are attached hereto under exhibit 3. The document has been revised and approved by the independent auditors Mr. Bendis Husi and Ms. Gerta Avrami certifying their accordance to Albanian legislation without reservations.

After a brief but comprehensive discussion, the Supervisory Board, by unanimous resolution of all its members:

**RESOLVES**

**To approve the Company Financial statement for the Financial year 2019 revised by the independent auditors and the related activity reports.**

4. With regard to the **fourth topic** of the agenda, the Chairman invites the Administrators to inform the meeting on the details of the Corporate System Framework ("CSF"). The Administrators give the floor to Mr. Andrea Romeo, who informs the meeting that the document has been drafted throughout the first semester of 2020 and has been completed within June 30th with the support of the Company Departments and it aims to provide an overall and complete picture of the Company processes & activities and presents the core of AGSco normative system. Furthermore, it allocates responsibilities and accountabilities for each process. The details of the CSF are attached hereto under exhibits 4.1 and 4.2

After a brief but comprehensive discussion, the Supervisory Board, by unanimous resolution of all its members:

**RESOLVES**

**To approve the Corporate System Framework design.**

5. With regard to the **fifth topic** of the agenda, the Chairman informs the participants that Mr. Giuseppe Peluso notified his resignation as Administrator (Chief Operating Officer, "COO") of the Company, with effect from 21.07.2020, as stated in the resignation communication sent to the members of the Supervisory Board and duly kept in the Company's files. Following the above resignation and considering the operative needs of the Company, it is therefore appropriate to appoint a new COO of the Company, in accordance with article 19 of the Company's Articles of Association, as well as to confer the related powers to the new COO.

After a brief but comprehensive discussion, the Supervisory Board, by unanimous resolution of all its members

**RESOLVES**

1. **To approve the resignation of Mr. Giuseppe Peluso from 21.07.2020**
2. **To appoint Mr. Roberto Zingoni, an Italian citizen born on 24.11.1971 in Milano with registered address at: via Trivulziana 52, San Donato Milanese, Italy, adult and in**

**full capacity to act, as the new Administrator (COO) of the Company, for a term of 3 years, starting form 22.07.2020**

3. **To confer to Mr. Roberto Zingoni all the powers conferred and foreseen for the position of Administrator (COO) by the Supervisory Board with resolution dated 27 December 2018.**

6. The Chairman invites the Members or the Administrators to discuss any other issues regarding the meeting. The Administrators inform the meeting on the need to amend the item "Subcontractor" within Company budget 2020. The Administrators inform the meeting that in order to carry out maintenance activities within the scope of services of the Maintenance Agreement with TAP, the Company needs to contract one or more companies ("the subcontractors") for the execution of certain activities that are contractually foreseen to be subcontracted (e.g. emergency services, civil works, pipeline repairs, fiber optic repairs, diesel supply, waste management, cleaning services etc.). TAP has recently given the Company additional information on other urgent services that are needed and should be procured (some of such activities being "Diesel supply for installed equipment/generators" and "Cleaning Services").
The Administrators recall that the inclusion of subcontractor element within 2020 budget of 1.2 million (one million two hundred thousand) Euro (with 1.26 million (one million two hundred sixty thousand) Euro as revenues) regarding core activities for emergency services, civil, mechanical and electrical works, as well as a fund of 100.000 (one hundred thousand) Euro for Waste management (adding 105.000 (one hundred five thousand) Euro as revenues) has been approved during the Supervisory Board Meetings of April 15th 2020 and June 17th 2020.

In order for the Company to initiate the procurement procedures, it is needed to open the positions in the budget and also to identify the appropriate revenues to fund these activities. Given the additional requests presented by the Client and their criticality for subcontractor services, the Administrator require the Board to consolidate the Subcontractor main category Item in two subcategories, the "Subcontractor main Contract" and "Subcontractor Other Contracts" and add the Items "Diesel supply for installed equipment/generators", "Cleaning Services for TAP" and "Waste management" in the second category. Given the inclusion of the two additional services, the Company budget would require a modification in the revenues and costs side as it is contractually agreed with TAP that subcontractor element would be reimbursed by TAP with a 5% mark-up. In light of the above the Administrators are asking for the approval of the modification of costs for a value of 100.000 (one hundred thousand) Euro (of which 50.000 (fifty thousand) Euro for "Diesel supply for installed equipment/generators" and 50.000 (fifty thousand) for "Cleaning services for TAP") and of revenues for a value of 105.000 € (one hundred five thousand).

After a brief but comprehensive discussion, the Supervisory Board, by unanimous resolution of all its members

**RESOLVES**

1. **To approve the consolidation of the Subcontractor main category with two subcategories "Subcontractor main Contract", and "Subcontractor Other Contracts"**

Albanian Gas Services Company Sh.a
Rruga e Kosovareve, Pallati NderPro sh.p. Tirana, Albania
Share Capital: ALL 3.500.000,00
NUIS: L82407006D

**2. To approve the inclusion of the for "Diesel supply for installed equipment/generators" and "Cleaning services for TAP" in the "Subcontractor Other Contracts" within Company budget 2020 in the figures of: 50.000 (fifty thousand) Euro for each of them, 100.000 (one hundred thousand) Euro in total as costs and their equivalent of 105.000 Euro as revenues.**

7. Finally, the Administrators inform the Board on the reallocation of certain economic resources in order to accommodate the needs for three expenditures:
   1. Materials needed in the Covid-19 situation. Given the Covid-19 situation, the Ministry of Health and Social Protection has issued guidelines for the necessary materials needed for each company in order to properly operate under the current situation. After conducting a market scouting activity, the Company needs to start procurement of the material. To accommodate the expenditure, the Administrators inform the meeting that 20.000 (twenty thousand) Euros from "ICT Opex" item have been reallocated.

   2. HSE PPE for electrical activities. After consulting the market given the need for the PPE Electrical equipment, the Administrators inform the meeting on the need to increase the allocated funds to 9.000 (nine thousand) Euro from 2.000 (two thousand) Euro initial allocation. The Administrators inform the meeting that 1.000 (one thousand) Euro from "ICT Opex" item and 6.000 (six thousand) Euro from "Other" (Property Insurance + Translation) have been reallocated.

   3. ICT Capex. Given the requests from O&M Manager for additional ICT equipment, the Administrators inform the meeting on the need to relocate 50.000 (fifty thousand) Euro from "ICT Opex" item to "ICT Capex" item.

The Supervisory Board acknowledge the reallocation of the cost items.

Nothing else having to be resolved and nobody asking to speak, the Chairman declares the meeting closed at 19:00, after the compiling, reading and approving of these minutes.

ALBANIAN GAS
SERVICE COMPANY AGS

Albanian Gas Services Company Sh.a
Rruga e Kosovareve, Pallati NderPro sh.p. Tiranë, Shqipëri
Kapitali aksioner: 3.500.000,00
NIPT: L82407006D

**VENDIM I BORDIT MBIKQYRËS**

**TË**

**"ALBANIAN GAS SERVICE COMPANY" SH.A**

Sot, më 21.07.2020, në orën 18.00, në zbatim të Statutit të shoqërisë ALBANIAN GAS SERVICE COMPANY SH.A, një shoqëri e krijuar rregullisht dhe që ekziston në bazë të legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, e regjistruar në regjistrin tregtar të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit me NIPT Nr. L82407006D, me adresë të regjistruar Rruga e Kosovarëve, pallati NderPro sh.p.k, Tiranë, Shqipëri **("Shoqëria"),** në bazë të Ligjit Nr. 9901/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar (Ligji për Shoqëritë Shqiptare), mblidhet Bordi Mbikëqyrës i Shoqërisë, i përbërë nga anëtarët e mëposhtëm:

- **Z. Mario Franchin;**
- **Z. Michele Cali;**
- **Z. Enea Karakaci**
- **Z. Oltion Rrumbullaku**
- **Z. Renald Koka**

për të diskutuar dhe vendosur mbi sa vijon

**AXHENDA:**

1. Përditësimi i aktiviteteve të tremujorit të parë 2020.

2. Përditësimi i aktiviteteve të Shëndetit, Sigurisë & Mjedisit, të tremujorit të parë të vitit 2020.

3. Miratimi i Pasqyrës Financiare të Shoqërisë për vitin Financiar 2019, e rishikuar nga Auditues të pavarur.

4. Miratimi i dizajnit të Kuadrit të Sistemit të Korporatës.

5. Dorëheqja e Z. Giuseppe Peluso nga funksioni i Administratorit (Drejtori i Përgjithshëm i Operimeve) të Shoqërisë dhe emërimi i një Administratori të ri (Drejtori i Përgjithshëm i Operimeve) të Shoqërisë, si dhe delegimi i kompetencave tek Drejtori i sapo zgjedhur i Përgjithshëm i Operimeve të Shoqërisë.

6. Ndonjë çështje tjetër.

Të gjithë anëtarët që morën pjesë në mbledhje kanë konstatuar si vijon:

- janë njoftuar rregullisht mbi mbledhjen dhe mbi axhendën dhe miratojnë çdo modalitet të njoftimit apo zhvillimit të kësaj mbledhjeje të Bordit Mbikëqyrës të Shoqërisë dhe e konsiderojnë atë të përbërë dhe të mbledhur vlefshmërisht;

- prania e anëtarëve në mbledhje, fizikisht apo nëpërmjet video konferencës, është në përputhje me kuorumin e parashikuar në Statut, si element i domosdoshëm për të konsideruar mbledhjen si të vlefshme, për të zgjidhur çështjet e axhendës. Në mbledhje marrin pjesë anëtarët e mëposhtëm:

- Z. Mario Franchin, *i cili merr pjesë nëpërmjet video konferencës*;
- Z. Michele Cali, *i cili merr pjesë nëpërmjet video konferencës*;
- Z. Enea Karakaci, *i cili merr pjesë nëpërmjet video konferencës*;
- Z. Oltion Rrumbullaku, *i cili merr pjesë nëpërmjet video konferencës*;
- Z. Renald Koka, *i cili merr pjesë nëpërmjet video konferencës*;

- Anëtarët e Bordit Mbikëqyrës kanë diskutuar dhe janë informuar mbi detajet e çështjeve që do të diskutohen dhe zgjidhen.

- Administratorët e Shoqërisë, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv Z. Arbër Lleshi dhe Drejtori i Përgjithshëm i Operimeve Z. Giuseppe Peluso, marrin pjesë gjithashtu në mbledhje;

- Z. Roberto Zingoni, Andrea Romeo, Massimiliano Lamberti Fontana dhe Parid Shkurti marrin pjesë gjithashtu në mbledhje;

- Për qëllime të kësaj mbledhjeje Z. Gabriele Lopez Cesarino është zgjedhur Sekretar, i cili ka pranuar emërimin e përkohshëm.

**PRANDAJ**

1. Lidhur me **pikën e parë** në axhendë, Kryetari fton Administratorët të japin në mbledhje një përditësim të aktiviteteve të vitit 2020, deri më sot. Administratorët ia japin fjalën Z. Gabriele Lopez Cesarino, i cili përditëson Anëtarët e Bordit Mbikëqyrës mbi aktivitetet e zhvilluara gjatë vitit 2020 deri më sot, sikurse përshkruhet në mënyrë të detajuar në dokumentin bashkëlidhur, si shtojca 1. Kryetari pyeti nëse plotësimi i dizajnit të prokurimit të paraqitur është i realizueshëm, duke pasur parasysh kërkesat e TAP-it dhe Procedurën e Prokurimit Publik. Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv informoi se po rishikohet drafti i Ligjit të ri të Prokurimit Publik dhe se gjatë muajve në vazhdim prokurimi i mallrave/punimeve/shërbimeve të caktuara, të domosdoshme për aktivitetet operacionale mund të mos jetë objekt i Ligjit të Prokurimit Publik. Gabriele Lopez Cesarino informon gjithashtu se gjashtë rregullat e Shoqërisë, që përbëjnë thelbin e Sistemit të Menaxhimit të Shoqërisë, janë hartuar dhe janë miratuar nga Administratorët. Së fundmi, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv dha një përditësim mbi shifrat ekonomike të aktiviteteve të vitit 2020 deri më 31 maj 2020. Bordi Mbikëqyrës pranon përditësimin e aktiviteteve të vitit 2020 deri më sot dhe miraton aprovimet e rregulloreve të Shoqërisë.

2. Lidhur me **pikën e dytë** në axhendë, Kryetari fton Administratorët të japin në mbledhje një përditësim mbi Shëndetin, Sigurinë & Mjedisin për gjysmën e parë të vitit 2020. Administratorët i japin fjalën Z. Andrea Romeo, Drejtori i Shëndetit, Sigurisë & Mjedisit, i cili shpjegon në mënyrë të detajuar ecurinë e aktiviteteve të Shëndetit, Sigurisë & Mjedisit, sikurse përshkruhet në dokumentin bashkëlidhës, si shtojca 2. Bordi Mbikëqyrës njeh dhe pranon përditësimin mbi Shëndetin, Sigurinë & Mjedisin për gjysmën e parë të vitit 2020.

3. Lidhur me **pikën e tretë** në axhendë, Kryetari fton Administratorët të informojnë në mbledhje mbi Pasqyrën Financiare të Shoqërisë për vitin 2019, të rishikuar nga Audituesit e Pavarur. Administratorët i japin fjalën Drejtorit të AFC-së, i cili shpjegon në mënyrë të detajuar tiparet kryesore të Pasqyrës Financiare. Veçanërisht, rezultatet ekonomike të pasqyrës së fitimit dhe humbjes paraqesin një përmirësim në të ardhurat operuese dhe në fitimin neto, lidhur me rishikimin e buxhetit të miratuar nga Bordi Mbikëqyrës në datën 9 prill 2019. Detajet e Pasqyrës Financiare të Shoqërisë për vitin 2019 bashkëlidhen si shtojca 3. Dokumenti është rishikuar dhe miratuar nga audituesit e pavarur Z. Bendis Husi dhe Zj. Gerta Avrami, të cilët vërtetojnë pa rezerva se është në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Pas një diskutimi të shkurtër por gjithëpërfshirës, Bordi Mbikëqyrës, me vendimin unanim të të gjithë anëtarëve të tij:

**VENDOS**

**Të miratojë Pasqyrën Financiare të Shoqërisë për vitin financiar të vitit 2019, të rishikuar nga auditues të pavarur, si dhe raportet përkatëse të aktivitetit.**

4. Lidhur me **pikën e katërt** në axhendë, Kryetari fton Administratorët të japin në mbledhje detaje mbi Kuadrin e Sistemit të Korporatës ("KSK"). Administratorët i japin fjalën Z. Andrea Romeo, i cili informon në mbledhje se dokumenti është hartuar gjatë tremujorit të parë të vitit 2020 dhe është përfunduar brenda datës 30 qershor, me mbështetjen e Departamenteve të Shoqërisë, dhe ka si qëllim të ofrojë një imazh të përgjithshëm dhe të plotë të proceseve & aktiviteteve të Shoqërisë dhe paraqet thelbin e sistemit normativ të AGSco. Gjithashtu, dokumenti përcakton përgjegjësitë dhe përgjegjshmëritë për çdo proces. Detajet e KSK-së ndodhen bashkëlidhur si shtojcat 4.1 dhe 4.2.

Pas një diskutimi të shkurtër por gjithëpërfshirës, Bordi Mbikëqyrës, me vendimin unanim të të gjithë anëtarëve të tij:

**VENDOS**

**Të miratojë dizajnin e Kuadrit të Sistemit të Korporatës.**

5. Lidhur me **çështjen e pestë** në axhendë, Kryetari informon pjesëmarrësit se Z. Giuseppe Peluso ka njoftuar se dorëhiqet si Administrator (Drejtori i Përgjithshëm i Operimeve "COO") i Shoqërisë, në fuqi që nga data 21.07.2020, sikurse theksohet në komunikimin e dorëheqjes që i është dërguar anëtarëve të Bordit Mbikëqyrës dhe që mbahet rregullisht në dosjet e Shoqërisë. Pas dorëheqjes së lartpërmendur dhe duke marrë parasysh nevojat operative të Shoqërisë, është e përshtatshme të caktohet një Drejtor i ri i Përgjithshëm i Operimeve i Shoqërisë, në përputhje me nenin 19 të Statutit të Shoqërisë, si dhe t'i jepen tagrat përkatëse Drejtorit të Përgjithshëm të Operimeve.

Pas një diskutimi të shkurtër por gjithëpërfshirës, Bordi Mbikëqyrës, me vendimin unanim të të gjithë anëtarëve të tij:

**VENDOS**

1. **Të miratojë dorëheqjen e Z. Giuseppe Peluso, nga data 21.07.2020.**

**2. Të emërojë Z. Roberto Zingoni, shtetas italian, lindur më 24.11.1971 në Milano, me adresë të regjistruar: via Trivulziana 52, San Donato Milanese, Itali, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, si Administratori i ri (Drejtori i Përgjithshëm i Operimeve) i Shoqërisë, për një kohëzgjatje 3 vite, duke filluar nga data 22.07.2020.**

**3. Ti japë Z. Roberto Zingoni të gjitha tagrat që janë dhënë dhe parashikuar për funksionin e Administratorit (Drejtori i Përgjithshëm i Operimeve) nga Bordi Mbikëqyrës, me vendimin e datës 27 dhjetor 2018.**

6. Kryetari fton Anëtarët ose Administratorët të diskutojnë mbi ndonjë çështje tjetër lidhur me mbledhjen. Administratorët informojnë në mbledhje se është e domosdoshme të ndryshohet zëri "Nënkontraktues" në buxhetin e Shoqërisë 2020. Administratorët informojnë në mbledhje se për të kryer veprimtaritë e mirëmbajtjes, sipas objektit të shërbimeve të Marrëveshjes së Mirëmbajtjes me TAP-in, Shoqëria duhet të kontraktojë një ose më shumë shoqëri ("nënkontraktuesit") për kryerjen e aktiviteteve të caktuara, që parashikohen për tu nën-kontraktuar me kontratë (p.sh. shërbimet e emergjencës, punimet civile, riparimet në gazsjellës, riparimet në fibrat optikë, furnizimi me naftë, menaxhimi i mbetjeve, shërbimet e pastrimit, etj. TAP-i i ka dhënë kohët e fundit Shoqërisë informacion shtesë mbi shërbimet e tjera urgjente që nevojiten dhe duhet të prokuroren (aktivitete të tilla si "Furnizim me naftë për pajisjet/gjeneratorët e instaluar" dhe "Shërbimet e pastrimit").
Administratorët sjellin në vëmendje se përfshirja e elementit nënkontraktues në buxhetin e vitit 2020 në shumën 1.2 milion (një milion e dyqind mijë) Euro (me 1.26 milion (një milion e dyqind e gjashtë dhjetë mijë) Euro të ardhura) lidhur me aktivitetet kryesore për shërbimet e emergjencës, punimet civile, mekanike dhe elektrike, si dhe fondi prej 100.000 (një qind mijë) Euro për menaxhimin e mbetjeve (duke shtuar 105.000 (njëqind e pesë mijë) Euro të ardhura) është miratuar gjatë Mbledhjeve të Bordit Mbikëqyrës të datës 15 prill 2020 dhe datës 17 qershor 2020.

Për të filluar procedurat e prokurimit nga Shoqëria, është e domosdoshme të hapen funksione në buxhet dhe gjithashtu të identifikohen të ardhurat e duhura për të financuar këto aktivitete. Duke pasur parasysh kërkesat e paraqitura nga Klienti dhe gjendjen e tyre kritike për shërbimet e nënkontraktuesit, Administratori i kërkon Bordit të konsolidojë zërin e kategorisë kryesore Nënkontraktues në dy nën-kategori, "Kontrata kryesore me nënkontraktuesin" dhe "Kontrata të tjera me nënkontraktuesin" dhe të shtohen zërat "Furnizimi me naftë për pajisjet/gjeneratorët e instaluar", "Shërbimet e pastrimit për TAP-in" dhe "Menaxhimi i Mbetjeve" në kategorinë e dytë. Duke pasur parasysh përfshirjen e dy shërbimeve plotësuese, buxheti i Shoqërisë do të kërkonte një ndryshim në të ardhurat dhe kostot, duke qenë se është rënë dakord me TAP-in në mënyrë kontraktuale se elementi nënkontraktues do të rimbursohet nga TAP-i me një vlerë 5% shtesë. Sa më sipër, Administratorët kërkojnë miratimin e ndryshimit të kostove për një vlerë 100.000 (njëqind mije) Euro (nga të cilat 50.000 (pesëdhjetë mijë) Euro për "Furnizimin me naftë për pajisjet/gjeneratorët e instaluara" dhe 50.000 (pesëdhjetë mijë) Euro për "Shërbimet e pastrimit për TAP-in") dhe të ardhurave në shumën 105.000 Euro) njëqind e pesë mijë).

Pas një diskutimi të shkurtër por gjithëpërfshirës, Bordi Mbikëqyrës, me vendimin unanim të të gjithë anëtarëve të tij:

**VENDOSI**

1. **Të miratojë konsolidimin e kategorisë kryesore Nënkontraktues me dy nënkategori "Kontrata kryesore me nënkontraktuesin" dhe "Kontratat e tjera me nënkontraktuesin".**

2. **Të miratojë përfshirjen e zërit "Furnizimi me naftë për pajisjet/gjeneratorët e instaluar" dhe "Shërbimet e pastrimit për TAP-in" në "Kontratat e tjera me nënkontraktuesin" në buxhetin e Shoqërisë për vitin 2020 në shifrat: 50.000 (pesëdhjetë mijë) Euro për secilin prej tyre, 100.000 (njëqind mijë) Euro në total si kosto dhe ekuivalentin e tyre 105.000 Euro si të ardhura.**

7. Së fundmi, Administratorët informojnë Bordin mbi ri-alokimin e burimeve të caktuara ekonomike, për të rakorduar nevojat për tre shpenzimet:

    1. Materialet që nevojiten lidhur me situatën Covid-19. Duke pasur parasysh situatën Covid 19, Ministria e Shëndetit dhe Mbrojtjes Sociale ka dhënë udhëzime për materialet e domosdoshme që nevojiten për çdo shoqëri për të operuar si duhet sipas situatës aktuale. Pas kryerjes së një aktiviteti të kërkimit në treg, Shoqëria ka nevojë të fillojë prokurimin e materialit. Për të rakorduar shpenzimet, Administratorët informojnë në mbledhje se është ri-alokuar shuma 20.000 (njëzet mijë) Euro nga zëri "ICT Opex".

    2. Shëndeti Siguria & Mjedisi, Pajisjet Mbrojtëse Personale për aktivitetet elektrike. Në vijim të konsultimit në treg, duke pasur parasysh nevojën për pajisje elektrike PPE (Pajisjet Mbrojtëse Personale), Administratorët informojnë në mbledhje se është e domosdoshme të rriten fondet e alokuara në 9.000 (nëntë mijë) Euro nga 2.000 (dy mijë) Euro alokim fillestar. Administratorët informojnë në mbledhje se janë ri-alokuar shumat 1.000 (një mijë) Euro nga zëri "ICT Opex" dhe 6.000 (gjashtë mijë) Euro nga "Të tjera" (Sigurimi i Pronës +Përkthim).

    3. ICT Capex. Duke pasur parasysh kërkesat nga Drejtori i O&M për pajisje shtesë TIK, Administratorët informojnë në mbledhje se është e domosdoshme të ri-alokohet shuma 50.000 (pesëdhjetë mijë) Euro nga zëri "ICT Opex" në zërin "ICT Capex".

Bordi Mbikëqyrës pranon ri-alokimin e zërave të kostos.

Duke pasur parasysh se asnjë çështje tjetër nuk mbetet për tu vendosur dhe asnjë person tjetër nuk kërkon të marrë fjalën, Kryetari deklaron mbledhjen të mbyllur në orën 19:00, pas përgatitjes, leximit dhe miratimit të minutave të mbledhjes.

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**
**DEGA VENDORE TIRANË**
**NOTER LORENC V. DAKA**

V20210530700522271534

**DATE 25/03/2021**
**NR REP 896**

NOTER TIRANË

## VËRTETIM PËRKTHIMI

Sot, më datë 25/03/2021, para meje Noter LORENC V. DAKA, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën BLV'GJERGJ FISHTA', p. nr.6, zyra nr.17, u paraqit personalisht:

**KERKUES**:
Drini Mataj, atësia Astrit, amësia Natasha, shtetas Shqiptar, lindur në Fier dhe banues në TIRANË, me adresë Grigor Heba; Nd. 27; H. 23; Ap. 12; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 12/12/1987, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034072299 dhe nr. personal I71212041E

**PËRKTHYES**:
Silvana Dervishi, atësia Hysen, amësia Hysnie, shtetase Shqiptare, lindur në Burrel, Mat dhe banues në Tiranë, me adresë Demir Progri Besar; Nd. 4; H. 24; Njësia Administrative Nr. 9; Njesia Bashkiake Nr. 9; 1016; Tiranë, lindur më 30/07/1979, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 036499195 dhe nr. personal H95730125E.

Përkthyesi është i licencuar nga Ministria e Drejtësisë, i cili/a më deklaroi se përktheu me përpikmëri dhe saktësi dokumentin bashkangjitur, nga gjuha angleze në gjuhën shqipe dhe e nënshkroi rregullisht përpara meje Noterit.

Në referim të nenit 135, i ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë";" në Republikën e Shqipërisë unë Noteri vërtetohet nënshkrimi i përkthyeses.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të këtij veprimi, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**NOTER**

LORENC V. DAKA

PULLE TARIFE
200
R.SHQIPERISE